



Januar / Dorezuar Priliceno/Prudato Received/Deliverty	12.09.2022	2	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Priloz Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5336/2022		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.341/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.341/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson

në Komunën e

Prishtinës, kundër Sqarimit me Nr.509 të datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.341/2022 e datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.13/52 i datës 29/12/2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

III. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Punëve të Brendshme-DMZP-ja **Obligohen** që ankuesit t'ia bëjnë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga dita e shkarkimit deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi konformë legjislacionit në fuqi.

IV. **Obligohet** Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e sistemuar ankuesin në një pozitë të mesme drejtuese në shërbimin civil në pajtim me legjislacionin në fuqi.

V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë që të kujdesen për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës III dhe IV të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi është emëruar në pozitën "Kryeshf Ekzekutiv" në Institutin Gjeologjik të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sipas vendimit me numër Nr.08/137 të datës 03.07.2013 nga Kryeministri i Kosovës me mandat tre (3) vjeçar, sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Me datën 23.12.2016 Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.05/122 sipas të cilit ankuesit i 'u ka vazhduar mandatin edhe për tri (3) vite në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me datën 05.12.2019 ka parashtruar propozimin për vazhdimin e mandatit të ankuesit për tek Këshilli për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, duke u mbështetur në vlerësimin tre (3) vjeçar në përmbushjen e obligimeve dhe objektive të planifikuara vjetore gjatë mandatit. Kryesuesi i Këshillit për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues me datën 22.01.2020, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.02/2020, sipas të cilit ka aprovuar raportin e vlerësimit tre vjeçar dhe i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës që t'i vazhdohet kontrata edhe për një mandat tre vjeçar ankuesit.

Bazuar në këtë vlerësim, Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, me datën 22.01.2020 ka nxjerr vendimin me numër Nr.03/117, sipas të cilit ankuesit i'a vazhduar mandatin si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës edhe për tri (3) vite, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.12.2021, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.31/52, me të cilin ka bërë shfuqizimin e Vendimit Nr.03/117 të datës 22.01.2020 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, me arsyetimin që ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës .

Me datën 04.03.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër A.nr.07/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 06.01.2022, si të pabazuar .

Ankuesi me datën 24.03.2022, përmes përfaqësuesit të tij ligjor, ka parashtruar kërkesë tek Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me emërimin e tij në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes aktit administrativ sqarues me numër Nr.509 të datës 04.04.2022, ka kthyer përgjigjen tek ankuesi në lidhje me kërkesën e tij.

Ankuesi i pakënaqur me aktin administrativ sqarues me numër 509 të datës 04.04.2022, nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 06.04.2022, përmes përfaqësuesit të tij ligjor ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1912/2022, me pretendimet ankimore se ky sqarim përmban shkelje ligjore dhe procedurale, i njëjti kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën e tij, ta anuloj sqarimin e DMZP-së të datës 04.04.2022, të sistemohet në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues si dhe ti paguaj pagat dhe beneficionet lidhur me pozitën Drejtor i Përgjithshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 15.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 2135/2022 për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa me datën 27.04.2022, Këshilli përmes shkresës me numër të protokollit 27.04.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Me datën 13.05.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin A.nr.341/2022, sipas të cilit e ka pezulluar procedurën lidhur me ankesën e ankuesit të datës 06.04.2022 e parashtruar në Këshill, me arsyetimin se lënda e ankuesit sipas Vendimit A.nr.07/2022 të datës 04.06.2022, ndërlihet me ankesën e ankuesit të datës 06.04.2022 e parashtruar në Këshill. Përfaqësuesi i ankuesit me datën 25.03.2022,ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative lidhur me anulimin e Vendimit A.nr.07/2022 të datës 04.03.2022 të Këshillit me propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi. Me datën 10.05.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.708/22 sipas të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit A.nr.07/2022 të datës 04.03.2022. Përfaqësuesi i ankuesit brenda afatit ligjor ka parashtruar padi tek Gjykata e Apelit të Kosovës kundër Vendimit A.nr.708/22 të datës 10.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me refuzimin e padisë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit. Gjykata e Apelit të Kosovës me datën 16.06.2022, ka nxjerrë Vendimin AA.nr.471/22 sipas të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit-paditësit lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit A.nr.07/2022 të datës 04.03.2022 të Këshillit, me q'rast ka vërtetuar Aktvendimin A.nr.708/22 të datës 10.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Ndërsa me datën 12.08.2022, përfaqësuesi i ankuesit ka dorëzuar kërkesën në Këshill, sipas të cilës kërkon që të vendoset lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.341/2022 të datës 06.04.2022, meqenëse e njëjta ka qenë e pezulluar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 1912/2022, të datës 06.04.2022; Autorizimin e datës 31.12.2021 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Vendimin me numër A.nr.07/2022 të datës 04.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën

e ankuesit me numër 451 të datës 24.03.2022 për tek Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Sqarimin me numër 509 të datës 04.04.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Parashtresën e datës 12.04.2022 të ankuesit lidhur me plotësimin e ankesës për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 27.04.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme; Kërkesën me numër 451 të datës 24.03.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit për DMZP-në dhe MPB-në lidhur me sistemimin e ankuesit në pozitë të nivelit të mesëm drejtues; Vendimin me numër Nr.13/52 të datës 29.12.2021 nga Qeveria e Kosovës; Vendimin Nr.05/122 të datës 23.12.2016 të Qeverisë së Kosovës; Vendimin Nr.08/137 të datës 03.07.2013 të Qeverisë së Kosovës; Vendimin Nr.03/117 të datës 22.01.2020 të Qeverisë së Kosovës; Aktvendimin AA.nr.471/22 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen e datës 23.05.2022, në kërkesën e ankuesit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 17.05.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit lidhur me korrigjimin e vendimit në Këshill; Aktvendimin A.nr.708/22 të datës 10.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A.nr.341/2022 të datës 13.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me procesverbal; Vendimin A.nr.82/2022 të datës 28.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale që janë dorëzuar nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar provat e lëndës dhe ka shqyrtuar edhe pretendimet e ankuesit sipas ankesës së plotësuar me parashtresën e datës 12.04.2022 me numër protokollit 2030/2022, i cili kundërshton shkresën e fundit Sqarimin-administrativ të datës 04.04.2022 të nxjerrë nga zv.Drejtoresha e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB/DMZP, ku i njëjti përmes ankesës së datës 06.04.2022 kërkon që të sistemohet në pozitë të nivelit të mesëm drejtues, si dhe të kompensohet për pagat dhe beneficionet lidhur me pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në mënyre retroaktive nga data 29.12.2021.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar shkresën e datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, ndërsa theksin e veçantë të arsyetimit të saj për shkak të mos realizimit të kërkesës së ankuesit të datës 24.03.2022, e bazon në nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që në këtë rast dispozitat që garantojnë sistemimin e ankuesit janë të aplikueshme vetëm kur përmbushen parakushtet sipas paragrafit 4 dhe 5 të nenit 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Emërimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet për një kohëzgjatje 4-vjeçare me të drejtë një rizgjatje, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje. 5. Rizgjatja e mandatit, në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, miratohet nga Qeveria, me propozim të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në performancën e tij. Propozimi bëhet të paktën 3 muaj para*

përfundimit të mandatit. Në rastin e institucioneve të tjera shtetërore, vendimi për rivazhdimin e mandatit merret nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”.

Kolegji, ndërlidhur me shkresën e datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB të lëshuar nga Zv. Drejtoresha për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik thekson faktin se përmbajtja e arsyetimit të shkresës së atakuar të pasqyruar si më lartë në këtë vendim, bie ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara si në nenin 83 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitat e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”* pasi që sipas shkresës së atakuar statusi i garantuar i nëpunësit civil sipas kësaj dispozite ligjore i humbet, madje sqarimi i dhënë përmes shkresës së datës 04.04.2022 bie ndesh edhe me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*, pasi që ankuesit sipas shkresës së atakuar i cenohet e drejta e ruajtjes së statusit të fituar të nëpunësit civil.

Me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 53 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: *“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj; 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishtëm”*, andaj Kolegji konstaton se Vendimi Nr.13/52 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 29.12.2021, nuk ka pasoja në të kaluarën, rrjedhimisht nuk ka pasoja para datës së nxjerrjes së vendimit por vetëm në të ardhmen, nga rrjedh se ankuesi nuk mundet që ta ushtrojë më tutje pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik, mirëpo i njëjti nuk e ka humbur statusin e nëpunësit civil, meqenëse vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk ka efekt retroaktiv-prapaveprues sipas dispozitave të specifikuara më lartë.

Bazuar në dispozitat e nenit 42 përkatësisht paragrafin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet se: *“7. Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimi detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”* dhe po ashtu në pajtim me nenin 15 paragrafin 1 të Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“1. Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale”*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi e ka pasur statusin e shërbyesit civil deri në momentin kur ishte vendosur të shfuqizohet Vendimi Nr.13/52 i Qeverisë së Republikës së

Kosovës i datës 29.12.2021 për vazhdimin e mandatit të ankuesit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB obligohet që ankuesin ta emërojë në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale në kuadër të Shërbimit Civil në administratën shtetërore.

Po ashtu, në pajtim me nenin 15 paragrafin 3 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ku përcaktohet se: *"Gjatë periudhës së pritjes për emërim, tre (3) muajt e parë të kësaj periudhe pas përfundimit të mandatit, nëpunësi e merr pagën e pozitës të cilën e ka ushtruar deri në përfundim të mandatit dhe mund të konkurrojë për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, përveç asaj për të cilën i ka mbaruar mandati"*, Kolegji konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB është i obliguar t'ia kompensojë ankuesit pagesën sipas nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues që nga data e pranimit të këtij vendimi deri në momentin e sistemimit, ndërsa afati për sistemimin e ankuesit rrjedh nga momenti i pranimit të vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht nenin 130 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën"*, ndërsa ankuesi përkundër faktit që me datën 06.04.2022 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshill kundër aktit administrativ-sqarimit të datës Nr.509 të datës 04.04.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe me datë 12.08.2022 pas pezullimit të procedurës lidhur me lëndën e ankuesit A.nr.341/2022 të datës 13.05.2022 nga Këshilli, i njëjti ka parashtruar kërkesë lidhur me vendosjen meritore për lëndën e ankuesit A.nr.341/2022 të datës 06.04.2022, i njëjti ka vazhduar ti vuaj efektet e pasojave juridike të akteve të lartcekura përmes të cilave ankuesi është larguar nga marrëdhënia e punës respektivisht i është ndaluar paga, andaj mbi këtë bazë si dhe në mbështetje të nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 53 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik është e obliguar t'ia bëjë ankuesit në mënyrë retroaktive kompensimin e pagave për tre muaj(3 muaj) nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës konkretisht nga vendimi Nr.13/52 i datës 29/12/2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës konformë nenit 42 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërsa MPB-ja përkatësishtë DMZP-ja është e obliguar që të i bëjë kompensimin e pagave të nivelit të mesëm drejtues pas kësaj periudhe deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi konformë legjislacionit në fuqi që rregullon këtë çështje,duke u obliguar njëkohësishtë Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesin-nëpunësin civil ta sistemoj në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 53 paragrafi 2 dhe nenit 132 paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.341/2022, datë 09.09.2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



- **Vendimi i dërgohet:**
- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit,
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

